



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Raport vjetor mbi veprimtarinë e
Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi
për vitin 2010

Për çdo informacion të mëtejshëm ju lutem na kontaktoni:
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10
Tek godina: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Kati II,
Tiranë

Përmbajtja

I - Fjala përshëndetëse e komisioneres	2
II - Krijimi i institucionit.....	3
III - Struktura organizative dhe forcimi i kapaciteteve administrative.....	4
1. Struktura organizative	4
2. Forcimi i kapaciteteve administrative	4
IV - Kuadri ligjor (i brendshëm dhe ndërkombëtar).....	7
1. Akte të krijimit dhe funksionimit të Zyrës së Komisionerit.....	7
2. Legjislacioni shqiptar	8
3. Legjislacioni ndërkombëtar në fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Mosdiskriminimit ..	8
4. Instrumente ligjorë të BE për përafrimin e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ...	12
V - Veprimtari të institucionit	13
VI - Trajtimi i ankesave.....	14
VII -Bashkëpunimi me aktorët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e diskriminimit.....	15
VIII -Pjesëmarrja në aktivitete e Komisionerit	16
IX - Marrëdhëniet financiare	18
X - Planet për periudhën në vazhdim	18
Shtojca 1: Struktura e zyrës së Komisionerit.....	20
Shtojca 2: Baza ligjore e Zyrës së Komisionerit	20
Shtojca 3: Formulari i ankesës	22

I - Fjala përshëndetëse e komisioneres

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Është kënaqësi dhe përgjegjësi e veçantë të paraqes raportin e parë vjetor të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD).

KMD u krijua nga Kuvendi i Shqipërisë si institucion i pavarur në ushtrimin e detyrës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. KMD filloi veprimtarinë e tij në Qershor 2010.

Krijimi i këtij institucioni erdhi si rezultat i kërkesave të BE për hapat që duhet të bënte Shqipëria për progres në procesin e integritimit evropian, si dhe pasqyroi angazhimin e autoriteteve Shqiptare drejt respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Objektivi kryesor i zyrës së komisionerit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është garantimi i mbrojtjes së subjekteve nga diskriminimi dhe pabarazia.

Raporti fokusohet në dy drejtime kryesore:

- ngritja institucionale, (nëpërmjet përshkrimit të krijimit, strukturës organizative dhe funksioneve të KMD)
- përshkrimi i aktiviteteve dhe veprimtarive kryesore të zyrës së komisionerit

Synimi kryesor i KMD për vitin 2010 ka qenë promovimi i ligjit dhe institucionit, në funksion të përmbushjes së prioritetëve dhe detyrimeve të zyrës së Komisionerit. Këtij synimi i kanë shërbyer dhe aktivitetet dhe veprimtaritë që janë organizuar në bashkëpunim me organizatat e tjera, që kanë si objekt të punës së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Veprimtaria e përshkruar në këtë raport ka qenë një sfidë për gjithë stafin e KMD, i cili megjithëse jo i plotë e ka përballuar me përkushtim. Realizimi i objektivave do të ishte i pamundur pa kontributin dhe punën e palodhur të stafit, të cilin gjej rastin ta falënderoj dhe të shpreh bindjen se kontributi i tyre i vlefshëm do të vazhdojë në arritjen e objektivave dhe konsolidimit të mëtejshëm në mbrojtjen nga diskriminimi dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Uroj që ky raport të jetë me interes dhe në dobi të lexuesve.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

II - Krijimi i institucionit.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 04.02.2010 miratoi ligjin Nr. 10 221, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i cili pas dekretimit nga Presidenti i Republikës dhe botimit në fletoren zyrtare, hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, erdhi me propozim të një grupi deputetësh dhe është një hap konkret në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nën frymën e dokumenteve ndërkombëtare dhe njëkohësisht, një hap konkret i përmbushjes së standardeve të anëtarësimit në BE.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin Nr. 33, datë 22.04.2010, “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” zgjodhi zonjën Irma Baraku në këtë detyrë, si dhe me vendimin Nr. 34, datë 20.05.2010 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” miratoi strukturën, organikën dhe kategorizimet e punës së zyrës së Komisionerit duke mundësuar kështu funksionimin dhe fillimin e punës së kësaj zyre.

Ministria e Financave me shkresën Nr. 10255/76 Prot. Datë 06.09.2010 mbi zbatimin e ligjit nr. 10310 datë 26.07.2010 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10190 datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, ka miratuar detajimin e fondeve të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Miratimi i këtij ligji dhe emërimi i Komisionerit është konsideruar si një arritje për Shqipërinë si në aspektin institucional ashtu dhe në atë të politikave anti-diskriminim. Në “Raportin Analitik 2010, që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, në Kapitullin 1.2, “Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve, Respektimi i të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut” faqe 27, shkruhet:

“Kudri institucional për të drejtat e njeriut është përforcuar përmes krijimit të një organi të barazisë. Në bazë të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi të miratuar në shkurt 2010, u emërua në muajin prill 2010 Komisioneri për mbrojtjen ndaj diskriminimit.”,

dhe në pjesën “Të drejtat ekonomike dhe sociale” faqe 30, shkruhet:

“Për sa i përket politikave anti-diskriminim, në shkurt 2010, Shqipëria miratoi një ligj për mbrojtjen nga diskriminimi. Ky ligj është hartuar në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare dhe shoqërinë civile; ligji rregullon zbatimin dhe sundimin e parimit të trajtimit të barabartë bazuar në një listë joshteruese arsyeshe ku përfshihen gjinia, raca, paaftësia fizike dhe mendore dhe orientimi seksual. Ligji po ashtu, parashikon krijimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.”

Bazuar në këtë ligj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Komisioneri do ta mbështesë punën e tij në zbatimin e të gjitha mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

III - Struktura organizative dhe forcimi i kapaciteteve administrative

1. Struktura organizative

Në periudhën Shtator 2010, pas rishikimit të ligjit për buxhetin e shtetit, ka filluar aktiviteti financiar, në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në përputhje me fondet e akorduara, ka vijuar procesi i emërimit me kontratë për pozicionet e parashikuara në organikën e zyrës prej 23 punonjësish të miratuar me Vendimin nr. 34, datë 20.5.2010 të Kuvendit të Shqipërisë (shtojca 1).

Në këtë proces i është kushtuar vëmendje kryesore përzgjedhjes së personave sipas aftësisë profesionale, komunikuese dhe cilësive personale.

Bazuar në procedurat e parashikuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, janë shpallur pozicionet e punës. Konkretisht janë shpallur 7 pozicione pune, ndër të cilat për 2 pozicione janë zhvilluar të gjitha procedurat ligjore për konkursin si dhe janë shpallur fituesit.

Për shkak të buxhetit të limituar për vitin 2010 nuk është vazhduar me plotësimin e pozicioneve të tjera të parashikuara në strukturë dhe organikë.

Ky fakt është theksuar dhe në “Raportin Analitik 2010, që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, në Kapitullin 1.2, Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve, Respektimi i të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut” faqe 27, në të cilin shkruhet:

“Megjithatë, kjo zyrë nuk është ende plotësisht funksionale. Është i nevojshëm një financim adekuat i kësaj zyre që të krijojë kapacitetet e duhura për shqyrtimin e ankesave dhe për ndërmarrjen e aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit në zbatim të parimit të trajtimit të barabartë.”

2. Forcimi i kapaciteteve administrative

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, stafi i Zyrës së Komisionerit ka marrë pjesë në disa trajnime, ku përmendim:

1. Pjesëmarrja në trajnimin me temë “Identifikimi i rasteve të diskriminimit dhe përfaqësimi i tyre para organeve administrative/gjyqësore dhe Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi”, të organizuar në datë 4-5 Nëntor 2010 nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), me mbështetjen financiare të Civil Rights Defenders.

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte promovimi dhe respektimi i së drejtës për të mos u diskriminuar në përputhje me aktet ligjore të miratuara nga shteti shqiptar, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të organizatave që ofrojnë shërbim ligjor falas dhe që kanë në fokusin e tyre çështjet e diskriminimit si dhe të rritjes së kapaciteteve të punonjësve të zyrës së Komisionerit.

Temat e prezantuara nga Av. Elira Kokona dhe Av. Kristaq Traja dhanë një përshkrim shumë të qartë teorik dhe praktik të çështjeve të ndryshme të trajtuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe analiza e disa çështjeve konkrete të gjykuara nga kjo gjykatë.

Me shumë interes u ndoqën dhe temat e mbajtura nga Dr. Sokol Sadushi dhe Av. Perikli Zaharia mbi procedurën që duhet të ndiqet në rastin e një ankese administrative si dhe paraqitja e kërkesë-padisë për mbrojtjen nga diskriminimi përpara gjykatave të sistemit të brendshëm.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin përfaqësues të organizatave të Klinikave Ligjore Falas: KShH (Komiteti Shqiptar i Helsinkit), TLAS (Shërbimi Ligjor Falas Tiranë), QNLQ (Qendra për Nisma Ligjore Qytetare) dhe FSHPAK (Fondacioni Shqiptar për Personat me Aftësi të Kufizuar) si dhe tri përfaqësues të zyrës së Komisionerit. Ky ishte ndër trajnimet e para që përfaqësues të zyrës së Komisionerit merrnin pjesë në një trajnim ku do diskutohej në lidhje me kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Trajnimi ishte parashikuar për të kontribuar në njohjen dhe zbatimin sa më të mirë të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për ngritjen e kapaciteteve të stafit të zyrës së Komisionerit si dhe vendosjen e lidhjeve dhe bashkëpunimin mes këtyre pjesëmarrësve.

2. Pjesëmarrja në trajnimin me temë “Human Rights in Practice”, organizuar nga UNV (UN Volunteers) Programme in Albania dhe JEF Albania (Young European Federalists). Në këtë trajnim, të zhvilluar më datë 10 - 13 nëntor 2010 në gjuhën angleze, morën pjesë tri përfaqësues të stafit të Zyrës së Komisionerit.

Përveç stafit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pjesëmarrës të tjerë në trajnim ishin edhe organizatat jofitimprurëse, vullnetarë dhe aktivistë të të Drejtave të Njeriut.

Qëllimi i trajnimit ishte zhvillimi i kapaciteteve për stafin e zyrës së Komisionerit, aktivistët e të Drejtave të Njeriut, punonjësit sociale dhe organizatat jofitimprurëse që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e të Drejtave të Njeriut, kryesisht për çështje që kanë të bëjnë me situatat e paqarta që ndeshin gjatë punës së tyre.

Objektivat themelore të këtij trajnimi ishin:

- Përgatitja e pjesëmarrësve me aftësi për të trajtuar në mënyrë efektive sfidat, intolerancën, diskriminimin dhe çështje të tjera të të Drejtave të Njeriut.
- Rritja e kapaciteteve të pjesëmarrësve në punën e tyre me grupe vulnerabël dhe komunitete multi-etnike, multi-kulturore dhe multi-fetare.
- Përgatitja e pjesëmarrësve si organizues të aktiviteteve trajnuese në fushën e të Drejtave të Njeriut.
- Lehtësimi i krijimit të rrjetit dhe bashkëpunimit të mëtejshëm mes pjesëmarrësve dhe organizimit ndërmjet tyre si trajnues të të Drejtave të Njeriut.

Përfitimi i Stafit të Komisionerit konsistonte në ngritjen e kapaciteteve dhe aftësive përsa i përket njohjes me konceptet, terminologjisë dhe praktikimit të bazës teorike të zhvilluar gjatë trajnimit.

Përveç rolit të mësipërm, stafi pjesëmarrës nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, luajti rol aktiv gjatë trajnimit në prezantimin e institucionit të ri, ligjit “Për Mbrojtjen nga

Diskriminimi”, mënyrës se si mund t’i drejtohen subjektet e ligjit Komisionerit për rastet e pretendimit për diskriminim si dhe çështje të tjera, për të cilat u zgjua interesi nga pjesëmarrësit nëpërmjet pyetjeve dhe komunikimit interaktiv.

3. Pjesëmarrja në workshop-in me temë: “Struktura efektive dhe të pavarura për promovimin e barazisë” organizuar nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës, të zhvilluar me datë 8 Korrik 2010.

4. Në datën 29 Nëntor - 2 dhjetor 2010, u zhvillua një vizitë studimore në Britaninë e Madhe, të ftuar nga Anëtarët e Grupit Parlamentar për Aftësinë e Kufizuar, ku u trajtuan këto çështje:

- Historiku i këtij grupi parlamentar,
- Prezantimi i projektit të OSCE dhe këshillit Britanik Forcimi i kapaciteteve institucionale të KKPAK (Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuar),
- Gjetjet nga dokumentacioni i vizionit dhe drejtimit strategjik të Këshillit (KKPAK),
- Prezantimi i grupit të lartë të advokacisë për PAK – barazia 2025,
- Perspektivat e punësimit të PAK-së.

Ky aktivitet ishte organizuar nga OSBE dhe Këshilli Britanik.

5. Takim pune me KKPAK dhe OSCE, në datat 16 – 17 Dhjetor 2010 ku u trajtuan këto çështje:

- Forcimi i kapaciteteve institucionale të Këshillit Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuar ,
- Raporti i përmbledhur i vizitës studimore në Londër,
- Prezantimi mbi gjetjet paraprake të dokumentit strategjik KKPAK,
- Finalizimi i gjetjeve të dokumentit strategjik dhe piketime të udhërrëfyesit për hapat e mëtejshme.
- Prezantimi i raportit mbi kapacitetet institucionale të KKPAK,
- Dokumentari Një ditë nga jeta e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri .

6. Nga data 29 Gusht deri më 3 Shtator 2010, në bashkëpunim me Ambasadën e Holandës në Shqipëri u organizua një vizitë pune pranë institucionit të Komisionerit Holandez për Trajtimin e Barabartë.

Kjo vizitë shërbeu në disa aspekte:

Së pari, u krijua mundësia për tu njohur dhe vendosur kontakte me homologët tanë që kanë një eksperiencë të gjatë në këtë fushë.

Së dyti, u krijua mundësia të njohim jo vetëm ligjin dhe kompetencat e këtij institucioni, por edhe të evidentojmë ndryshimet qoftë në kompetenca ashtu edhe në mënyrën e organizimit dhe funksionimit.

Së treti, patëm mundësi të shohim praktikisht se si zhvillohej veprimtaria nga ky institucion, ambientet dhe si ndiqej një çështje në të gjitha fazat e saj.

IV - Kuadri ligjor (i brendshëm dhe ndërkombëtar)

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një institucion i pavarur i cili i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi. Kuadri ligjor mbi të cilin mbështetet organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e Komisionerit si dhe baza ligjore, përfshirë legjislacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar, që parashikon parimin e mosdiskriminimit paraqitet si më poshtë:

1. Akte të krijimit dhe funksionimit të Zyrës së Komisionerit

Me miratimin e ligjit nr 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe hyrjen e tij në fuqi me datë 13.03.2010 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përmbushje të detyrimeve të krijuara nga ky ligj ka hartuar dhe miratuar **aktet e krijimit të Zyrës së Komisionerit** ku përfshihen:

- Vendim nr 33, datë 22.04.2010 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”
- Vendim nr. 34, datë 20.05.2010 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

Në kuadër të përmbushjes së detyrimit ligjor dhe ushtrimit të veprimtarisë së brendshme në mënyrë sa më efektive nga Zyra e Komisionerit, me urdhrin nr. 10 datë 21.12.2010, është hartuar dhe miratuar **Rregullorja e Brendshme** e organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Komisionerit dhe sektorëve të veçantë të këtij institucioni. Në këtë dokument përcaktohet në mënyrë të hollësishme gjithë veprimtaria e brendshme e institucionit për organizimin, funksionimin e strukturave të tij, disiplinën e brendshme në institucion si dhe drejtimin e administrimit të përditshëm të veprimtarisë së tij.

Gjithashtu, me urdhrin nr. 11 datë 21.12.2010 është miratuar **Kodi i Etikës** së institucionit. Në këtë Kod përcaktohen rregullat e sjelljes së punonjësve të Zyrës së Komisionerit gjatë ushtrimit të funksioneve sipas standardeve të bazuara në parimet e shtetit ligjor.

Në zbatim të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Drejtoria e Çështjeve Procedurale, Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë ka hartuar **formularin e ankesës**, si një ndër aktet e brendshme themelore për inicimin e procedimit administrativ, në rastin kur një person apo grup personash paraqesin ankesën e tyre për pretendim diskriminimi, gojarisht, duke iu referuar kërkesave ligjore për një akt të tillë (shtojca 3).

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Hetim - Inspektimit pranë Komisionerit ka punuar për përpilimin e disa **modele shkresash** të cilat do të shërbejnë për procedurat e hetim-inspektimit, të cilat rezultojnë si më poshtë:

- Urdhër për kryerjen e hetimit-administrativ
- Procesverbal i hetimit administrativ
- Relacion mbi hetimin e zhvilluar
- Rekomandime lidhur me hetimin –administrativ
- Vendim për kundravajtje administrative

Gjatë ushtrimit të funksioneve, detyrave dhe kompetencave të veta, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i nënshtrohet të gjitha rregullave dhe normave të përfshira në funksionimin e administratës publike. Në këtë kuadër ligjor përfshihen: ligji nr. 8503 datë 13.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, ligji nr 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”, ligji nr 8549 datë 11.11.1999 “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, ligji 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar etj.

2. Legjislacioni shqiptar

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në pjesën e dytë të saj të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si vlera që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik shqiptar. Këto të drejta janë të ndara në: liri dhe të drejta vetjake; liri dhe të drejta politike; si dhe liri dhe të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore. Në nenin 18/1 të Kushtetutës është parashikuar parimi i barazisë në të cilin sanksionohet se “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit” dhe në nenin 18/2 parimi i mosdiskriminimit në përmbajtjen e të cilit sanksionohet se “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore” dhe se “Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e mësipërme, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.

Ligji nr 8485 datë 12.05.1999 “**Kodi i Proceduarave Administrative**” është një tjetër akt mbi bazën e të cilit operon Komisioneri gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Normat e parashikuara në të zbatohen veçanërisht gjatë trajtimit dhe shqyrtimit të ankesave që i drejtohen, kryesisht për procedurat që duhen ndjekur, përveç rasteve kur këto janë të parashikuara në ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Ligji nr 10 221 datë 04.02.2010 “**Për Mbrojtjen nga Diskriminimi**” është ligji organik mbi bazën e të cilit sigurohet mbrojtja nga Diskriminimi si dhe në kuadër të zbatimit të këtij ligji është krijuar edhe institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si person juridik publik i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij si dhe autoriteti përgjegjës i cili siguron mbrojtje efektive nga Diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë joshteruese shkaqesh. Komisioneri ka kompetenca për të pranuar ankesa në lidhje jo vetëm me sektorin publik, por edhe me sektorin privat dhe individët. Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore janë të parashikuara në tre krerë më vete dhe përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim si dhe gjatë periudhës së ushtrimit të marrëdhënieve të punës, në fushën e arsimit si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi.

3. Legjislacioni ndërkombëtar në fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Mosdiskriminimit

Legjislacioni ndërkombëtarë në fushën e të Drejtave të Njeriut përfshin një sërë aktesh përsa i përket njohjes, promovimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Republika e Shqipërisë pasi i ka nënshkruar dhe ratifikuar i ka bërë pjesë të sistemit të brendshëm juridik. Efekti i zbatimit të

tyre dhe fuqia juridike janë përcaktuar në Kushtetutën e R.Sh, si akt themeltar. Në hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e R.Sh, menjëherë pas Kushtetutës vendosen marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i R.Sh. Këto të fundit në fushën e diskriminimit luajnë një rol të rëndësishëm përse i takon veprimtarisë së Komisionerit dhe rolit të tij si garant i mosdiskriminimit.

Në legjislacionin ndërkombëtar i cili trajton të drejtat e njeriut dhe diskriminimin përfshihen:

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e cila përmban tekstin e ndryshuar me Protokollin nr. 11 dhe 14, shoqëruar nga Protokollin nr 1, 4, 6, 7, 12 dhe 13. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut u nënshkrua në Romë më 4 nëntor të vitit 1950 dhe hyri në fuqi me 3 shtator të vitit 1953. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 1996.

Në nenin 14 të KEDNJ parashikohet “ndalimi i diskriminimit”, në përmbajtjen e të cilit thuhet se “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”. Siç mund të konstatohet, në këtë nen mbrojtja nga diskriminimi gjen zbatim në lidhje me ato të drejta dhe liri themelore të parashikuara në Konventë dhe në Protokollin e saj shtesë.

Ndërkaq, Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, ka përcaktuar se shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe nënshkruese të këtij Protokollin, përfshirë edhe Shqipërinë, duke pasur parasysh parimin themelor, sipas të cilit “të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë për një mbrojtje të njëjtë nga ligji”, të vendosur për të ndërmarrë hapa të mëtijshëm për të nxitur barazinë e të gjithë personave nëpërmjet zbatimit kolektiv të një ndalimi të përgjithshëm të diskriminimit në kuadrin e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 ; duke ripohuar që parimi i mosdiskriminimit nuk i ndalon Shtetet Palë të marrin masa me qëllim që të nxisin një barazi të plotë dhe efektive, me kusht që këto masa të kenë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, kanë parashikuar në nenin 1 *ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit*, ku sanksionohet në mënyrë të shprehur se “Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër” dhe se “Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1”. Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, është ratifikuar nga Shqipëria në nëntor 2004 dhe ka hyrë në fuqi me 5 prill 2005.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948 thekson parimin e papranueshmërisë së diskriminimit dhe shpall se të gjithë njerëzit lindin të lirë e të barabartë në dinjitet e në të drejta dhe se secili mund të gëzojë të gjitha të drejtat dhe liritë që përmenden aty, pa asnjë dallim. Kjo deklaratë ka proklamuar parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit në një dispozitë të vetme (neni 7) që parashikon se “Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të

gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë”.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore ka sanksionuar se “Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të garantojnë që të drejtat e shpallura në këtë Pakt, të ushtrohen pa kurrfarë diskriminimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare a shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër”. Ky pakt është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Shqipëria e ka ratifikuar Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në vitin 1991.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike ka sanksionuar në përmbajtjen e të drejtave të përfshira në përmbajtjen e tij se: “T gjith njer zit jan t barabart p rpara ligjit dhe kan t drejt mbrojtjeje t barabart t ligjit pa kurrfar dallimi. Lidhur me k t , ligji duhet t ndaloj çdo diskriminim dhe t garantoj p r t gjith , mbrojtje t barabart dhe efektive, kund r çdo diskriminimi e sidomos p r shkak t rac s, ngjyr s, seksit, gjuh s, fes , opinionit politik dhe çdo opinion tjet r, origjin s komb tare apo shoq rore, pasuris , lindjes ose çdo suate tjet r”. Ky pakt është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Shqipëria e ka ratifikuar Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike në vitin 1991.

Kuadri ligjor që parashikon dhe sanksionon parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit në aspektin e legjislacionit ndërkombëtar që garanton mbrojtje të të Drejtave të Njeriut përfshin gjithashtu edhe ato akte që janë miratuar nga organizatat ndërkombëtare në çështje, fusha dhe shkaqe specifike ku ndeshet diskriminimi.

Konventa mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas e nënshkruar në vitin 1979 dhe hyrë në fuqi më 1981 është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh në vitin 1994. Ndërsa Protokollin Fakultativ i Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, i vitit 1999 i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2000, është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh në vitin 2003. Konventa mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas ka përcaktuar në preambulën e saj se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor, pengon pjesëmarrjen e grave, në të njëjtat kushte me burrat, në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë e të familjes, dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbim të vendeve të tyre dhe njerëzimit, Konventa ka përcaktuar në nenin 1 të saj kuptimin e termit "diskriminim ndaj grave" si çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e gjinisë, e që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë, ose të shfuqizojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga statusi i tyre martesor, mbi bazën e barazisë së burrave dhe të grave, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër. Në këtë Konventë sanksionohet mbrojtja nga diskriminimi ndaj grave nëpërmjet masave të përkohshme të veçanta që synojnë përsheptimin *de facto* të barazisë midis burrave dhe grave; si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave me qëllim që t'i sigurohen atyre të drejta të barabarta me burrat në fusha të ndryshme si: në jetën politike dhe publike të vendit; në fushën e arsimit; në fushën e punësimit; për të parandaluar

diskriminimin ndaj grave për shkaqe martesore apo amësie, dhe për të siguruar të drejtën e tyre efektive për punë; në fushën e kujdesit shëndetësor për t'u siguruar, mundësitë për të përfituar shërbime mjekësore, duke përfshirë edhe ato të planifikimit familjar; në fushat e tjera të jetës ekonomike dhe shoqërore, si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare.

Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial e miratuar në vitin 1966 dhe hyrë në fuqi në vitin 1969 është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh në vitin 1994.

Kjo Konventë ka përcaktuar në Preambulën e saj se “të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe se kanë të drejtë të mbrohen në mënyrë të barabartë nga ligji kundër çdo diskriminimi si dhe kundër çdo nxitjeje për diskriminim”

Në këtë Konventë, shprehja “diskriminim racial” nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinin kombëtarë e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërrimor ose të komprometoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike. (neni 1)

Konventa përcakton detyrimin e shteteve palë të ndalojnë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave: Të drejtat politike ku përfshihen kryesisht: e drejta e pjesëmarrjes në zgjedhje, e drejta e votimit apo e drejta për të qenë kandidat, dhe për të pasur hyrje të barabartë në shërbimet publike. Të drejtat e tjera civile ku përfshihen kryesisht: e drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit në territorin e një shteti; e drejta shtetësisë; e drejta e martesës dhe e zgjedhjes së bashkëshortit/bashkëshortes; e drejta e pronësisë; e drejta e trashëgimisë; e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar; e drejta e lirisë së mbledhjes dhe krijimit të organizatave paqësore. Të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore ku përfshihen kryesisht: e drejta e punës; e drejta e krijimit të sindikatave dhe e antarimit në to; e drejta e strehimit; e drejta e trajtimit shëndetësor, sigurimit shoqëror dhe shërbimeve sociale; e drejta e arsimit dhe përgatitjes profesionale etj. (neni 5)

Konventa Evropiane Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare ka qëllim themelor sigurimin e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mos-diskriminimit për personat që i përkasin pakicave kombëtare. Kjo konventë ndalon çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare, duke përcaktuar detyrimin për palët nënshkruese të kësaj konvente, që t'i garantojnë personave që iu përkasin pakicave kombëtare të drejtën e barazisë para ligjit dhe të mbrojtjes së barabartë nga ligji. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e ka ratifikuar Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare në vitin 1999.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës garanton parimin e barazisë duke vendosur edhe detyrimin e shteteve palë që të ndërmarrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndërkulturore, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të

p rfaq svesve të tij ligjor ose të anëtarëve të familjes s tij. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e vitit 1989 ka hyrë në fuqi në vitin 1990 dhe është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh në vitin 1992.

Karta Sociale Evropiane ka sanksionuar parimin e barazisë (neni 20) duke përcaktuar në mënyrë të shprehur se “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit” dhe parimin e mosdiskriminimit (neni 21) ku theksohet se “Çdo diskriminim bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, etnia, origjina etnike apo shoqërore, gjuha, feja apo besimi, bindjet politike ose bindje të tjera, përkatësia në një minoritet kombëtar, vendbanimi, lindja, aftësia e kufizuar, mosha, orientimi seksual duhet të ndalohej”

Karta Sociale Evropiane e vitit 1961/1965 përbën një traktat kryesor evropian dhe e plotëson Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale. Karta Sociale Evropiane, e Rishikuar, e nënshkruar më 1998 dhe ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh në vitin 2002 po zëvendëson gradualisht Kartën Sociale Evropiane.

4. Instrumente ligjorë të BE për përafrimin e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

Në kuadër të aspiratës së vendit tonë për integrimin në Bashkimin Evropian dhe detyrimeve të përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, sistemi juridik shqiptar është përfshirë në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë evropian. Përafrimi i legjislacionit përbën një kusht themelor të përcaktuar në kuadër të kriterit të tretë të Kopenhagenit, kriterit administrativ (*acquis communautaire*), i cili nënkupton aftësinë për të përballuar detyrimet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe nënvizon nevojën e adoptimit, pra të miratimit dhe zbatimit të legjislacionit të BE në kuadrin ligjor të sistemit juridik shqiptar.

Në këtë proces të përafrimit, ka lindur nevoja për plotësimin e legjislacionit tonë në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. Ky fakt solli adaptimin e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në përputhje me Direktivat e BE në fushën e mosdiskriminimit, ku përfshihen: Direktiva e Këshillit Evropian 2004/43/KE e 29 qershorit 2000 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike". Direktiva e Këshillit Evropian 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për "Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës". Direktiva e Këshillit Evropian 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime". Direktiva e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për "Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".

Gjithashtu, miratimi i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është vlerësuar si hap pozitiv në procesin e përafrimit të legjislacionit të brendshëm me *acquis* edhe në Raportin Analitik të vitit 2010, që shoqëron komunikatën e Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin.

Kapitulli 19 “Politika sociale dhe punësimi” në të cilin shkruhet:

“Ligji Anti-Diskriminim i vitit 2010, përmirësoi ndjeshëm harmonizimin e legjislacionit me acquis” (Raporti Analitik, faqe 99).

V - Veprimtari të institucionit

Për rritjen e sensibilizimit dhe lehtësimin të aksesit të qytetarëve për t’iu drejtuar zyrës së Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi gjatë vitit 2010 janë kryer këto veprimtari:

1. Në bashkëpunim me OSBE është në proces realizimi i faqes Web të institucionit. Janë përgatitur dhe dërguar materialet me përmbajtjen e kësaj faqe, si psh: info broshura që përmban informacion për zyrën e komisionerit dhe përmbajtjen e ligjit, informacione të tjera mbi ligjin shqiptar dhe aktet ndërkombëtare, formulari i ankesës etj.
2. Është në proces krijimi i bibliotekës së Zyrës së Komisionerit nëpërmjet grumbullimit dhe përkthimit të dokumenteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi (si konventa, deklarata, pakte ndërkombëtare etj). Në këtë kuadër janë mbledhur dhe përkthyer direktivat e KE me të cilat është përafuar ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në kuadër të procesit të përafritimit të legjislacionit shqiptar me acquis communautaire të EU, si dhe po analizohen e përshtaten disa vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe disa vendime të GJEDNJ në kontekstin e zhvillimeve aktuale shqiptare.
3. Bashkëpunimi me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Konkretisht pranë këtij institucioni në zyrën e regjistrimit të Shoqatave/Fondacioneve/Qendrave që operojnë brenda territorit të Shqipërisë u realizua evidentimi i subjekteve që kanë në fokus të punës së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kryesisht mbrojtjen nga çdo lloj diskriminimi. Krijimi i bazës së të dhënave përkatëse të këtyre subjekteve pati si qëllim të tij edhe krijimin e kontakteve të reja (përveç atyre ekzistuese me grupin e punës) në kuadër të bashkëpunimeve të ndryshme në të ardhmen.

22 Nëntor 2010 dhe 26 Nëntor 2010 në Berat dhe Vlorë janë organizuar seminarët trajnuese me temë “Standardet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi” në të cilin merrnin pjesë përfaqësues nga Bashkia, Këshilli i Qarkut, drejtoria rajonale e punësimit si dhe përfaqësues nga disa Komuna.

Në kontekstin e sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve me ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe institucionin e Komisionerit, janë kryer këto aktivitete:

Së pari, është hartuar, prezantuar dhe shpërndarë në disa organizata fletëpalosja kryesore me informacion njohës dhe sensibilizues për mbrojtjen nga diskriminimi, duke i adresuar të gjithë subjektet e ligjit për ndihmën ligjore që institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ofron në këtë fushë.

Së dyti, Komisioneri në kuadër të promovimit të zyrës dhe njohjes me ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ka marrë pjesë në disa debate televizive me synim informimin e publikut si dhe ka qenë prezent në disa media të shkruara me artikuj të ndryshëm.

VI - Trajtimi i ankesave.

Gjatë vitit 2010 pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë ardhur 4 ankesa me pretendim për diskriminim për shkaqe të ndryshme.

Bazuar në ligjin nr. 10221 datë 04/02/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesat i janë nënshtruar procedurave të parashikuara duke filluar me verifikimin e fakteve për pretendimet përkatëse.

Në vijim të renditura, ankesat e ardhura pranë zyrës së Komisionerit gjatë vitit 2010:

1. Ankesa e ardhur me datë 09/11/2010, pasi është analizuar, shqyrtuar duke përfshirë dhe dëgjimin e subjektit që pretendonte për diskriminim është finalizuar me shkresën “kthim përgjigje” datë 06/12/2010, ku subjektit në fjalë, i janë argumentuar, bazuar në ligjin nr. 10221 datë. 04/02/2010 “ Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, arsyet pse kjo çështje nuk mund të shqyrtohej me tej nga Zyra e Komisionerit. Këto arsye kanë të bëjnë me faktet:
 - në rastet kur faktet që përbejnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të ligjit ankesa nuk mund të pranohet.
 - Komisioneri vihet në lëvizje në kuadër të zbatimit dhe respektimit të parimit të mosdiskriminimit vetëm në rastet kur subjektet e legjitimuara hyjnë në marrëdhënie me organet shtetërore shqiptare dhe pretendojnë diskriminim vetëm nga ana e tyre.
2. Ankesa e ardhur me datë 23/11/2010 ka subjekt një shtetas shqiptar ish-punonjës i Policisë së Shtetit i cili pretendon se është diskriminuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Dosja e subjektit në fjalë është analizuar me hollësi dhe është në procedurë e sipër. Nga analiza është vërejtur se në ankesë subjekti në fjalë nuk ka treguar shkakun e diskriminimit që ai pretendon si dhe nuk ka argumentuar pse është trajtuar ndryshe për këtë shkak. Si pasojë me shkresën nr. 38 prot datë 06/12/2010 drejtuar subjektit në fjalë, i janë kërkuar të dhënat e mësipërme, çka do të shërbejë si bazë për vazhdimin e shqyrtimit të çështjes.

Me shkresë datë 24/12/2010, subjektit në fjalë i ka kthyer përgjigje kërkesës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në të cilën shprehet, por që nuk arrin të identifikojë as shkakun dhe as të argumentojë trajtimin ndryshe siç parashikon ligji.

Në këto kushte Komisioneri është në procedurë e sipër e cila parashikon vënien në dijeni të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë kundrejt të cilëve është paraqitur ankesa dhe kërkimi i shpjegimeve për rastin në fjalë.

3. Ankesa e ardhur me datë 07/12/2010 është paraqitur nga LGBT PRO/PINK Emmbassy dhe Aleanca Kundër Diskriminimit të personave LGBT, dhe pretendon diskriminim nga nënkryetari i Komisionit Parlamentar të Punës Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë për konsideratën e shprehur ndaj këtij komuniteti si dhe nga Komisioni Parlamentar i Punës Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë për mosmarrjen parasysh të kërkesës së kësaj shoqate ne një seancë dëgjimore të këtij komisioni.

Kjo çështje është trajtuar duke shqyrtuar të dhënat e paraqitura nga ankuesi dhe nga burime të tjera.

Bazuar në nenin 33 pika 5 të ligjit nr. 10221 datë 04/02/2010 “ Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, me shkresë nr. 48 datë 21/12/2010 dhe nr. 48/1 datë 21/12/2010, subjektet që pretendohet të kenë kryer diskriminim janë njoftuar për ankesën dhe përmbajtjen e saj.

Procedura mbi këtë çështje është në vazhdim.

4. Ankesa e ardhur me datë 23/12/2010 është paraqitur nga një shtetase shqiptare dhe pretendon se është diskriminuar për shkak të përkatësisë gjinore nga Firma e ndërtimit “Bedhia shpk”.

Çështja në fjalë i është nënshtruar trajtimit ligjor duke analizuar dokumentacionin dhe pretendimet e paraqitura nga subjekti ankues.

Është organizuar dhe një seancë dëgjimore me pjesëmarrjen e subjektit ankues për të sqaruar pretendimet e ngritura në ankesë.

Lidhur me këtë ankesë procedura është në vazhdim.

VII - Bashkëpunimi me aktorët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e diskriminimit.

Ndër prioritetet e punës së komisionerit është vendosja e bashkëpunimit me të gjithë aktorët që kanë në objekt të punës së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut e në mënyrë të veçantë mbrojtjen nga diskriminimi, duke përfshirë Organizatat Ndërkombëtare (si Delegacioni i Bashkimit Evropian, OSBE, PNUD, UNIFEM, etj) si dhe OJF-të, fondacionet, media, etj.

Me synimin për të realizuar prioritetet e punës së Zyrës së Komisionerit si dhe në kuadër të përmbushjes së funksioneve të zyrës, Komisioneri ka bashkëpunuar me këto aktorë:

Me institucionet shtetërore si: Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministria e Punës e Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta, Ministria e Integritit, organet e pushtetit vendor, etj.

Në koordinim me Ministrinë e Integrimit është bërë prezantimi i raportit në takimin e nën-komitetit KE- Shqipëri (Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale) në të cilin Komisioneri ka raportuar për pikën 5.2 Mosdiskriminimi (kuadri ligjor dhe politikat) mbajtur në Bruksel më 18 nëntor 2010.

Në bashkëpunim me PNUD janë zhvilluar një cikël trajnimesh në disa qarqe të vendit me qëllim informimin e pushtetit lokal me përmbajtjen e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” si dhe funksionimin e zyrës së Komisionerit.

Në bashkëpunim me fondacionin SOROS janë hedhur hapat e parë për hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit të zyrës së komisionerit. Kjo Strategji e zhvillimit të zyrës do të jetë një instrument për Komisionerin për të gjithë aktorët e tjerë publik dhe jopublik, për një kuptim të përbashkët të situatës së mosdiskriminimit, sfidave që shtrihen përpara dhe përballimin e tyre. Kjo strategji do të parashtrijë bashkëpunimin dhe bashkërendimin mes të gjithë aktorëve, rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse, për të arritur në një qasje efikase dhe të harmonizuar në luftën për mbrojtjen nga diskriminimi. Gjithashtu po bashkëpunohet dhe për organizimin e trajnimeve për stafin e zyrës.

Në datë 15 dhjetor 2010, Komisioneri organizoi tryezën e rumbullakët me grupin e punës, në të cilin u prezantua aktiviteti i zyrës. Në këtë takim, u shkëmbyen informacione dhe opinione mbi gjendjen e diskriminimit në Shqipëri dhe forcimit të bashkëpunimit si dhe drejtimet kryesore në të cilin duhet të fokusohet puna e Komisionerit për të realizuar objektivat e Zyrës. Grupi i punës përbëhet nga përfaqësues nga disa organizata ndërkombëtare dhe kombëtar, ku mund të përmendim përfaqësues nga Delegacioni i BE, OSBE, PNUD, Ambasada Holandeze, KShH, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, Pink Embassy, SOROS dhe Qendra për Nisma Ligjore Qytetare.

Gjithashtu në bashkëpunim me OSBE me qëllim pasqyrimin dhe mundësinë e kontaktimit të Zyrës së Komisionerit në Internet, është në proces krijimi i faqes zyrtare të institucionit.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës po punohet për rekomandimet mbi Projektligjin “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar”.

VIII - Pjesëmarrja në aktivitete e Komisionerit

Në kuadër të vendosjes së kontakteve dhe njohjes së Komisionerit dhe ligjit “Për mbrojtjen nga Diskriminimi” gjatë këtij viti Komisioneri ka marrë pjesë në disa aktivitete të zhvilluara si brenda dhe jashtë vendit, kështu do të evidentonim si më poshtë vijon:

- 3–4 Qershor 2010, pjesëmarrja në konferencën kombëtare Përballja me stereotipet gjinore , e organizuar nga OSCE, MPÇSShB, UNIFEM, UNFPA.

Konkluzionet dhe rekomandimet shërbejnë si rekomandime e propozime për Planin e ri të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, 2011–2014.

- 4 Qershor 2010, pjesëmarrja në konferencën rajonale Për Mbrojtjen nga Diskriminimi organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Civil Rights Defenders. Në këtë aktivitet u diskutuan disa tema:
 - Kultura mosdiskriminuese e popullit shqiptar në lidhje me përkatësinë fetare dhe etnike.
 - Praktika ligjore e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut në lidhje me parandalimin e diskriminimit.
 - Ligji shqiptar Për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe përqsasja e tij me standardet e Bashkimit Evropian.
 - Rastet e përhapura të diskriminimit, parandalimi dhe rikuperimi i së drejtës.
 - Instrumentet ligjor, teknik dhe organizativ për institucionin e Komisionerit përballë diskriminimit.
- 7 Qershor 2010, diskutime mbi versionin paraprak të një raporti lidhur me Evidentimin e kuadrit ligjor, institucional dhe politikave të antidiskriminimit në Turqi dhe Ballkanin Perëndimor . Raporti i organizatave Konsulenca Njerëzore Evropiane dhe Grupi i Politikave Migratore.
- 8-9 korrik 2010, pjesëmarrja në workshop-in “Struktura efektive dhe të pavarura për promovimin e barazisë” e organizuar nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës.
- 18 Tetor 2010, pjesëmarrja në workshop-in “Forcimi i kapaciteteve institucionale të Këshillit Kombëtar Shqiptar të Personave me Aftësi të Kufizuar”. Tryezë e rumbullakët e organizuar nga OSCE dhe Këshillin Britanik.
- 26 Tetor 2010, Tryeza e dialogut me Komunitetin Transgjinor.
- Tetor - Nëntor 2010 në bashkëpunim me gjyqtarët e shkallës së parë të rrethit gjyqësor Tiranë janë organizuar trajnime mbi njohjen dhe interpretimin e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
- 10 Dhjetor 2010, Konferenca Shpallja për diskutim publik e Projektligjit për Arsimin Parauniversitar , organizuar nga MASH.
- 17 Dhjetor 2010, Debati III-të Kombëtar për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri. Ky aktivitet u organizua në tre panele:
 - Modele të mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve në konflikt me ligjin,
 - Të drejtat e grave në Shqipëri,
 - Mbrojtësit e të drejtave të Komunitetit LGBT në Shqipëri.

Komisioneria Irma Baraku, referoi temën: Mbrojtja nga diskriminimi i mbrojtësve të të drejtave të njeriut .

- 20 Dhjetor 2010, Seminar Kombëtar i organizuar nga Avokati i Popullit dhe TLAS me temë “Shoqëria Shqiptare - Sfidat e mosdiskriminimit”, në të cilin Komisioneri referoi temën: “Diskriminimi i drejtpërdrejtë- diskriminimi i tërthortë”.

IX - Marrëdhëniet financiare

Institucioni i Komisionerit në zbatim të ligjit nr.10310 datë 26.07.2010 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10190 datë 26.11.2009 «Për buxhetin e vitit 2010»”, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.1 datë 21.01.2010 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010”, si dhe në mbështetje të shkresës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr.13 datë 26.08.2010 “Mbi detajimin e Buxhetit të Rishikuar 2010”, në planin e buxhetit të shpenzimeve korente për vitin 2010, ka realizuar treguesit buxhetor të mëposhtëm:

Emërtimi	Plan	Fakt	Diferenca	Vlerat në %
Paga dhe Sigurime Shoqërore	5,500,000	4,084,792	1,415,208	74.268945
Mallra dhe Shërbime të tjera	2,000,000	1,999,551	449	99.97755
Investime	0	0	0	0
Totali	7,500,000	6,084,343	1,415,657	87.123248

Buxheti i Komisionerit është bërë aktiv me detajimin me nr. prot. 10255/76 datë 06.09.2010 në zbatim të ligjit nr. 10310 datë 26.07.2010.

VKM për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë nr. 929, datë 17.11.2010 dhe largimi i Drejtorit të Drejtorisë së Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë reflektuan në paga dhe sigurime shoqërore një ulje prej 21.3% në ndryshim nga parashikimet e bëra.

X - Planet për periudhën në vazhdim

Për institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbetet prioritet rritja dhe shtrirja e sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve për garancitë që ofron ligji nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” si dhe njohja me ekzistencën e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si mekanizëm ligjor i cili ofron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nxitjen për respektimin dhe zbatimin e parimit të barazisë.

Objektiv themelor mbetet dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe ndërmjetësimi i punës me të gjithë aktoret që kanë në objekt të punës së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut sidomos në fushën e mosdiskriminimit, përfshirë institucionet shtetërore (Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrinë e Brendshme etj) organizatat ndërkombëtare (Delegationin e Bashkimit Europian, OSCE, UNDP, UNIFEM) OJF-të, fondacionet, media, etj.

Veçanërisht, bashkëpunimi me institucionet shtetërore do të konsistojë në analizimin e situatave ligjore përse i përket diskriminimit dhe detyrimin ligjor për bërjen e rekomandimeve në kuadër të hartimit të ndryshimeve në legjislacionin ekzistues apo propozimin për miratimin e legjislacionit të ri.

Synimi ynë është jo vetëm realizimi i detyrave të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare, por edhe ofrimi i një shërbimi për qytetarët që të jetë sa më i përafëruar me autoritetet homologe në vende të zhvilluara.

Duke qenë se institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një institucion i ri, puna e tij do të jetë e përkushtuar ndaj mbrojtjes nga diskriminimi të të gjitha subjekteve të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Prioritetet kryesore të Zyrës për vitin në vazhdim, do të jenë:

- Pjesëmarrja dhe angazhimi në seminare, konferenca dhe trajnime me synim rritjen e kapacitetit të stafit të zyrës.
- Vazhdimi i bashkëpunimit me fondacionin SOROS për trajnimin e stafit dhe hartimin e strategjisë afatmesme për periudhën 2011-2013 për zhvillimin e Zyrës së Komisionerit.
- Forcimi i bashkëpunimit me organizatat e tjera si: Delegationin e BE-së, Qendra e Informimit të BE-së, OSBE, shoqërinë civile, etj.
- Përfundimi i procesit të rekrutimeve të stafit të Zyrës.
- Rritja e efikasitetit të Zyrës për marrjen, shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të subjekteve që pretendojnë diskriminim.
- Zhvillimin e kuadrit ligjor, etj.


Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

Irma BARAKU

Shtojca 1: Struktura e zyrës së Komisionerit

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMISIONERIT PER MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



Shtojca 2: Baza ligjore e Zyrës së Komisionerit

1. Akte të krijimit dhe funksionimit të Zyrës së Komisionerit

Rregullore e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kodi i Etikës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Vendim nr 33, datë 22.04.2010 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

Vendim nr. 34, datë 20.05.2010 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

2. Legjislacioni i brendshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Ligj nr. 8503 datë 13.06.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare”

Ligj nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”

Ligj nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”

Ligj nr. 8549 datë 11.11.1999 “Për Statusin e Nëpunësit Civil”

Ligj nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar.

3. Legjislacioni ndërkombëtar

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (teksti i ndryshuar me Protokollet nr. 11 dhe 14, shoqëruar nga Protokollet nr 1, 4, 6, 7, 12, 13)

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Karta Sociale Evropiane, e rishikuar

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial

Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera, ose Dënimeve Çnjerëzore jo Humane dhe Degraduese

Konventa Evropiane Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës

4. Instrumente ligjorë të BE për përafrimin e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

Direktiva e Këshillit European 2004/43/KE e 29 qershorit 2000 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike"

Direktiva e Këshillit European 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për "Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës"

Direktiva e Këshillit European 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime"

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit European 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për "Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".

Shtojca 3: Formulari i ankesës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Adresa: Rruga Sami Frashëri, nr.10
Tiranë – Shqipëri

Tel: _____
E-mail: _____
Website: _____

Nr. Regjistri _____

Tiranë, më ____/____/____

ANKESË

Drejtuar: Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

<u>Të dhënat e ankuesit</u>	<u>Organizatë me interesa legjitime¹</u>
Emri/atësia/ mbiemri _____	Emri i organizatës _____
Datëlindja _____	_____
Profesioni _____	_____
Shtetësia _____	_____
Kombësia _____	_____
Tel/fax _____	Emër/mbiemër i personit të kontaktit:
Cel _____	_____
E-mail _____	_____
Gjinia F <input type="checkbox"/> M <input type="checkbox"/>	Tel/ Fax _____
Adresa _____	Cel _____
_____	Adresa _____

PËRMBAJTJA E ANKESËS

1. Subjekti që pretendohet të ketë kryer diskriminim ose shpjegimin për pamundësinë e identifikimit të tij

2. A po shqyrtohet e njëjta çështje në kuadër të një ankese tjetër apo për të është marrë një vendim i mëparshëm?

¹ Ankesa duhet të shoqërohet me kopjen e vendimit për krijimin e organizatës.

